



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË AKADEMIJA E SHKENCAVE**  
**Instituti i Arkeologjisë**

**Tiranë, më 5.8.2024**

**Njoftim për pozicion të lirë pune**

Në zbatim të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* (i ndryshuar), të nenit 58 paragrafi 6 të *Statutit* të saj (i ndryshuar); në mbështetje të VKM nr. 821 datë 28.12.2023 *Për ngritjen dhe organizimin e njërive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë*; si dhe të Vendimit nr. 4, datë 10.1.2024 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave *Për strukturën e organikën dhe për emërimin e punonjësve kërkimorë-shkencorë dhe të administratës ndihmëse të instituteve të albanologjisë* e të të rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave (e ndryshuar), shpall konkursin për 3 (tre) vende të lira pune në Institutin e Arkeologjisë:

- 1. Dy punonjës kërkimorë-shkencorë në departamentin e antikitetit të vonë dhe mesjetës (kërkues shkencorë / asistent-kërkues shkencorë), sipas nenit 60 paragrafi 4 të Statutit, me gradën/diplomën doktor i shkencave / master shkencor me rezultate shumë të larta;**
- 2. Një punonjës kërkimor-shkencor, sipas nenit 60 paragrafi 3 të Statutit (asistent kërkues-shkencor) në departamentin e prehistorisë me gradën/diplomën doktor i shkencave / master shkencor me rezultatet shumë të larta.**

**- Kandidatët që aplikojnë për vendet e punës sipas pikës 1 duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si më poshtë:**

**Kritere të përgjithshme:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën e njësuar shqipe, me shkrim e të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore të mira, që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të plotësojë kriteret specifike të vendosura në bazë të përshkrimit të vendit të punës për formimin, kualifikimin, përvojën etj.;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që përbën pengesë ligjore;
7. Të mos ketë masë ndëshkimore në fuqi, nga komisionet e etikës, për shkelje të kodit të kërkuesit shkencor ose mësimitdhënësit (vetëdeklarim ose vërtetim);

8. Të jetë a të vendoset me banim në Tiranë;
9. Të ketë fituar gradën shkencore *doktor i shkencave*;
10. Të jetë cilësuar si studiues i vlefshëm në një fushë specifike të studimeve arkeologjike;
11. Të ketë jo më pak se 10 pjesëmarrje në ekspedita kërkimore;
12. Kandidati duhet të ketë të paktën dy referenca nga profesorë të fushës së arkeologjisë.

Pranohen kandidatët që, përveç kriterëve të përgjithshme, plotësojnë edhe kriteret e veçanta, si më poshtë:

#### **Kriteret e veçanta:**

1. Të njohë mirë teknikat e gërmimit në vendbanime dhe nekroplet antiko-mesjetare;
2. Të ketë përvojë mbi 5-vjeçare në gërmime arkeologjike;
3. Të njohë mirë qeramikën dhe materialin arkeologjik të periudhës së vonë antike dhe mesjetare;
4. Të njohë gjerësisht literaturën e fushës përkatëse të studimit.

#### ***Dokumentet që duhet të paraqesin kandidatët:***

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur pranë zyrës së protokollit të Akademisë së Shkencave, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

1. Kërkesën me shkrim;
2. Fotokopje e faqes së parë të pasaportës ose të kartës së identitetit;
3. Curriculum vitae, me të dhënat personale e profesionale (ku të përfshihet edhe lista e plotë e botimeve, me një përshkrim 4-6 rreshta për çdo botim shkencor);
4. Fotokopjet e noterizuara të diplomave universitare fituar brenda apo jashtë vendit (në rastin e fundit, ekuivalentuar ose në proces ekuivalentimi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit);
5. Origjinalet ose fotokopjet e plota të së paku dy botimeve (libra, artikuj, ligjërata), me referencën e plotë të tyre shënuar në krye;
6. Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së zotërimit të një gjuhe ndërkombëtare (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht); për kandidatët që e kanë kryer shkollimin jashtë vendit mjafton diploma e noterizuar e universitetit të huaj;
7. Dy rekomandime nga dy profesorë të arkeologjisë;
8. Letër motivimi (1-2 faqe) me të cilën kandidati tregon arsyet e konkurrimit dhe nivelin e përgatitjes së tij për pozicionin e shpallur në konkurrim;
9. Projekt-program kërkimor (2-4 faqe), ku kandidati paraqet përshkrimin e një projekti kërkimor që ai/ajo synon të realizojë në tre vitet e arshshme në specialitetin ku aplikon.

**- Kandidatët që aplikojnë për vendin e punës *asistent kërkues-shkencor* sipas pikës 2 duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të parashtruara si më poshtë:**

#### **Kritere të përgjithshme:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën e njësuar shqipe, me shkrim e të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore të mira, që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

5. Të plotësojë kriteret specifike të vendosura në bazë të përshkrimit të vendit të punës për formimin, kualifikimin, përvojën etj.;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që përbën pengesë ligjore;
7. Të mos ketë masë ndëshkimore në fuqi, nga komisionet e etikës, për shkelje të kodit të kërkuesit shkencor ose mësimdhënësit (vetëdeklarim ose vërtetim);
8. Të jetë a të vendoset me banim në Tiranë;
9. Të ketë diplomën *master shkencor* me rezultate shumë të larta;
10. Të ketë aftësi të veçanta tekniko-shkencore dhe ekseriencë të dokumentuar në fushën e gërmimit dhe dokumentimit të tij;
11. Të ketë marrë pjesë në të paktën në 5 (pesë) ekspedita kërkimore në terren;
12. Të ketë mbrojtur një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze);
13. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunuese;
14. Të ketë të paktën dy referenca nga profesorë të arkeologjisë.

#### **Kritere të veçanta:**

1. Duhet të njohë mire teknikat e gërmimit dhe të dokumentimit në vendbanime dhe nekropole tumulare;
2. Të ketë përvojë mbi pesë vjet në ekspedita në terren;
3. Të njohë mirë qeramikën dhe materialin arkeologjik të prehistorisë dhe protohistorisë;
4. Të njohë gjerësisht literaturën e fushës përkatëse të studimit.

#### **Dukumente për dorëzim:**

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur pranë zyrës së protokollit të Akademisë së Shkencave, dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

1. Kërkesën me shkrim;
2. Fotokopje e faqes së parë të pasaportës ose të kartës së identitetit;
3. Curriculum vitae me të dhënat personale e profesionale;
4. Fotokopjet e noterizuara të diplomave universitare fituar brenda apo jashtë vendit (në rastin e fundit, ekuivalentuar ose në proces ekuivalentimi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit);
5. Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së zotërimit të një gjuhe të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht); për kandidatët që e kanë kryer shkollimin jashtë vendit mjafton diploma e noterizuar e universitetit të huaj;
6. Dy rekomandime nga dy profesorë të arkeologjisë;
7. Letër motivimi (1-2 faqe), me të cilën kandidati tregon arsyet e kandidimit dhe nivelin e përgatitjes së tij për pozicionin në konkurrim.

#### **Afati i dorëzimit të dokumenteve:**

Pranimi i dokumenteve bëhet deri më datën 14.9.2024, ora 16.00. Gjatë kësaj periudhe kandidatët kanë të drejtën të konsultohen me njësinë përgjegjëse të personelit për plotësimin e dokumentacionit.

### **Mënyra e vlerësimit:**

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me datën 20.9.2024.

### **Verifikimi paraprak:**

Rezultatet e verifikimit paraprak të kryer nga njësia, me emrat e kandidatëve që i plotësojnë kriteret, do të shpallen më datë 16.9.2024 në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen nuk publikohet. Njësia i bën të ditur çdo kandidati veçmas arsyen e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse brenda 3 (tri) ditë pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tri) ditë pune nga data e depozitimit të saj.

### **Verifikimi i kandidatëve**

Kandidatët e kualifikuar duhet të paraqiten më datën 20.9.2024 ora 11.00 për zhvillimin e konkursit pranë KPP.

### **Vlerësimi bëhet për:**

- a). Arsimimin, kualifikimin e aktivitetin e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin që gjendet në dosje;
- b). Botimet, pjesëmarrjet në konferenca, pjesëmarrjet në kërkime në terren;
- c). Intervistën me gojë;
- d). Projektin kërkimor.

Totali i pikëve në vlerësimin e kandidatëve është 100 (njëqind) pikë dhe ka këtë strukturë:

- a). 25 për qind për formimin profesional;
- b). 25 për qind për botimet, pjesëmarrjen në konferenca dhe për kërkimet në terren;  
vlerësimin në bashkëbisedimin me gojë;
- c). 20 për qind për bashkëbisedimin;
- d). 30 për qind për projektin kërkimor.

### **Fazat e konkurrimit:**

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a). Verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe specifike të domosdoshme prej kandidatëve;
- b). Vlerësimi i kandidatëve.

## **Shpallja e rezultateve dhe njoftimi i fituesit:**

### *Verifikimi paraprak*

Rezultatet e verifikimit paraprak të kryer nga njësia, me emrat e kandidatëve që i plotësojnë kriteret, do të shpallen më datë 16.9.2024 në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave, në rrjetet sociale të institucionit dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Lista e kandidatëve që nuk kualifikohen nuk publikohet. Njësia i bën të ditur çdo kandidati veçmas arsyen e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse brenda 3 (tri) ditë pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tri) ditë pune nga data e depozitimit të saj.

### *Vlerësimi i kandidatëve*

Kandidatët e kualifikuar duhet të paraqiten më datën **20.9.2024 ora 11.00** për zhvillimin e konkursit pranë KPP. Rezultati për çdo kandidat del nga shuma e pikëve të dhëna për të nga anëtarët e KPP. Në bazë të tyre do të përcaktohet renditja e kandidatëve.

Lista me emrat e konkurruesve me mbi 65 pikë i dërgohet njësisë përgjegjëse të personelit, e cila *shpall fitues të parin që renditet në listë*. Emri dhe profili profesional i fituesit *i njoftohen Kryesisë*. Kryetari i ASHSH bën emërimin në detyrë të fituesit. Fituesi brenda tri ditësh lidh kontratën e punës me institucionin të përfaqësuar nga drejtori i Institutit të Arkeologjisë.

Njësia bën publik vendimin për emërimin përmes faqes zyrtare të institucionit.

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë Sheshi “Fan Noli”, Tiranë [www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**